Vdekje fashizmit — Liri Popullit

Poštarina plaćena u gotovu
Taksa postale e paguème

RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

ИЗЛАЗИ ДВА ПУТА НЕДЕЉНО: ЧЕТВРТКОМ И НЕДЕЉОМ
DEL DY HERE NE JAVE: ""EJTEN DHE TE DJELEN

Redaksija: Prishtine
Rruga Emin Duraku Nr. 1

PAJTIMET
per 1 vit 192 din
— 6 muej 94 —
— 3 muej 48 —

Dorshkrimet nuk kthehen

Odgovorni urednik XHELADIN
Drejtori pergjegjes HANA

Vjeti IV Nr. 121 | PRISHTINE, e djele 4 Korrik 1948 | Çmimi 2 dinarë

DEKLARATA E KOMITETIT QENDROR TE PARTIS KOMUNISTE TE JUGOSLLAVIS NE LIDHJE ME REZOLUTEN E BYROS INFORMATIVE TE PARTIVE KOMUNISTE MBI GJENDJEN NE PARTIN KOMUNISTE TE JUGOSLLAVIS

Rezoluta e Byros Informative "Mbi gjendjen ne Partin Komuniste te Jugosllavis" siç shihet prej saje, e ka parahistorin e vet.

Bazen e saje e perbajne letrat e KQ te PK (b) te BRSS, drejtue KQ te PKJ. Letren e pare, te 27 marsit te ketij vjeti, ku KQ i PK (b) te BRSS ka paraqite akuzat e tija kundra KQ te PKJ, Komiteti Qendruer i PK (b) te BRSS ua ka dergue njikohesisht te gjitha partive antare te Byros Informative, e per kete gja nuk asht informue KQ i PKJ. Mbas kesaj, me anen e KQ te PKJ (b) te BRSS, ka mberrijte letra e KQ te PK te Hungaris, ku ne te gjitha pikat asht i perkrahun qendrimi i KQ te PK (b) te BRSS. Letra e KQ te Hungaris u asht dergue edhe partive tjera. Mbas kesaj, KQ i PKJ ka marre letra te ngjajshme edhe nga partinat tjera-antare te Byros Informative me perjashtim t'asaj italjane dhe franceze. KQ i PKJ thekson se partinat e permenduna, ne baze, e kane pranue pikpamjen e KQ te PK (b) te BRSS para se t'a kene ndie mendimin ase t'a kene ndigjue ndonji argument te kundert te KQ te PKJ. Mbas kesaj letre te KQ te PK (b) te BRSS dhe letrave te permenduna te komiteteve tjera qendrore, si edhe mbas pergjegjes te KQ te PKJ Komitetit Qendruer te PK (b) te BRSS me 13 prill te ketij vjetit, KQ i PKJ ka marre dhe letra tjera nga KQ i PK (b) te BRSS me 4 dhe me 22 maj, te cilat, pak a shum, kane qene ne linjen e letres se pare. Rezoluta e Byros Informative "Mbi gjendjen ne PKJ" kryesisht asht nji perseritje e ketyne letrave te KQ te PK (b) te BRSS.

Ne keto letra KQ i PK (b) te BRSS e ka akuzue KQ te PKJ dhe ka kerkue prej tij t'i pohoje gabimet si: e para, se njerzit udheheqesa te PKJ, me fjale, e lavdojne BRSS-en e mshefturi shpifin edhe kundra Bashkimit Sovjetik edhe kundra PK (b) te BRSS; e dyta, se njerzit udheheqesa te Jugosllavis shpifin kundra Armates sovjetike dhe se ekspertat sovjetike i kane kqyre me anmiqesi, e se qytetaret sovjetike dhe shokun Judin e gjurmojne organet e sigurimit shteteruer; e treta, se kuadrat e Partis jane vue nen mbikqyrjen e Ministrit te punve te mbrendshme dhe se ne Parti nuk ka demokraci e kritike, por mbretnon sistemi i udheheqjes ushtarake; e katerta, se qeverija Jugosllave, me ane te spijujve, don me e sigurue mediren e shteteve imperjaliste dhe te vehet nen kontrollin e tyne; e pesta, se Partija shkaperderdhet ne Frontin populluer, se nuk mund te konsiderohet organizate marksiste-lenjiniste dhe se perkundert ne theorinat e Bernshtajnit, Buharinit e Folmarit mbi shkrienjen paqesore t'elementave kapitaliste ne socjalizem; e gjashta, se perfaqesuesi i njenit t'nga shtetet e mdhaja imperjaliste sillet ne Jugosllavi si zot shtepije dhe se miqet e kulakeve e zhelanit te popujve te Jugosllavis, Nedliqit, vendosen lehte dhe me komoditet n'aparatin shteteruer e te partis te Jugosllavit; e shtata, se udheheqsit Jugosllav e indentifikojne politiken e jashtme te BRSS me politiken e jashtme te shteteve imperjaliste; e teta, se njerzit udheheqesa te PKJ jane shmange nga rruga marksiste-lenjiniste ne çashtjen e rolit udheheqes te klases puntore; e nanta, se parashutistat giermanit e kane shpartallue shtabin „partizan" ne Jugosllavi, se mbas kesaj asht krijue krize e rande ne levizjen nacjonal-çlirimtare, e se mandej Armata Sovjetike ka ardhe ne ndihme, e ka çlirue Jugosllavin dhe i ka krijue kushtet qe Partija Komuniste te vije ne pushtet; e dheta, se Partija Komuniste e Jugosllavis e ka ba namin tue u lavdrue me suksesset e saja ne luftë, megjithse nuk ka merita ma te mdhaja se partinat komuniste te Polonis, Çekosllovakis, Rumanis, Hungaris, Shqipnis, Bullgaris etj. etj. Ketyne akuzave duhet t'u shtohen edhe ato qe permenden ne rezolute, e qe ketu nuk jane numrue ne menyre te shkoqitun.

KQ i PKJ, siç shihet nga deklarata qe hyrnja politike e KQ te PKJ ia ka drejtue kesionit te byros informative, e te cilen po e bashkangjesim, nuk ka muejte me diskutue ne baze t'akuzave te ketilla te Komitetit Qendruer te PK (b) te BRSS, te bazueme ne shpifje, trillime e ne mosnjoftjen e gjendjes ne Jugosllavi, per deri sa te mos konstatohet gjendja faktike dhe te ndalet e paverteta nga vrejtjet vertete parimore, qofshin te Komitetit Qendruer te PK (b) te BRSS, ase te cilitdo komitet tjeter qendruer te partive — antare te byros Informative.

Me rastin e shpalljes se Rezolutes se permendun te byros Informative, Komiteti Qendruer i Partis Komuniste te Jugosllavis deklaron sa vijon:

E para: Kritika ne Rezolute bazohet ne pohime jo te sakta dhe te pathemelta dhe synon me rrenue autoritetin e Partis Komuniste te Jugosllavis perjashta dhe mbrenda, me mbjelle peshtjellim ne masat, vend dhe ne levizjen puntore nderkombetare, me e dobesue unitetin e PKJ dhe rolin e saje udheheqes. Aq ma i çuditshem asht fakti qe KQ i PKJ (b) te BRSS refuzoi me i kontrollue mu ne vend thanjet e veta, siç ka propozue KQ i PKJ ne letren e tij te 13 prillit te ketij vjeti.

E dyta: ne rezolute, pa dhane kurrfare fakti, thuhet se udheheqsija e PKJ ndjeke politiken anmiqsore ndaj Bashkimit Sovjetik. Pohimi se ne Jugosllavi jane nençmue socjalistat

(vazhdon ne faqen e dyte)

Jemi thellsisht te bindun ne drejtesin e linjes se Komitetit Qendruer te Partis s'one, me shokun Tito ne krye

Telegram

SHOKUT TITO DHE KQ TE PKJ

BEOGRAD

Te dashtun shoke,

Nga mbledhja e jone e perbashket, na antaret e Partis te qytetit te Prishtines ju pershendesim dhe deklarojme se mbetemi te paperkulshem ne linjen e Partis s'one. Nuk pajtohemi me Rezoluten e Byros Informative te partive Komuniste mbi gjendjen ne Partin t'one, sepse permban shpifje dhe akuza te padrejta kundra Partis s'one dhe Komitetit t'one Qendruer. Konsiderojme se ato akuza dhe shpifje jane padrejtesija ma e madhe historike qe u asht ba popujve t'one. Te gjitha ketyne, ne do t'u pergjigjemi tue i dyfishue te tana fuqit t'ona per nde rtimin sa ma te shpejte te socjalizmit ne Vendin t'one, plot bindje se Komiteti i yne Qendruer, me shokun Tito ne krye, na ka pri dhe na prin ne rrugen e drejte kah socjalizmi dhe se vija e Partis s'one asht e drejte.

T'udhehequn nga shkenca marksiste-lenjiniste, do t'a mbajme kompkatesin e Partis s'one dhe qendrimin e drejte ndaj te gjitha partive Komuniste motra.

Pershendesim shokun Tito dhe KQ, ma besim te forte dhe bindje se se shpejti do te bine poshte te gjitha shpifjet dhe akuzat qe nuk kane kurgja te perbashket me gjendjen ne Partin t'one.

Aktivi i Partis - Prishtine

NE NDERE TE KONGRESIT TE PESTE TE PARTIS KOMUNISTE TE JUGOSLLAVIS

Frontistat e Shajkovcit te rrethit te Podujeves i jane pervesh punes me vrull ne ndere te Kongresit

Organizatat e Frontit te Keshillit te vendit te Frontit populluer te Shajkovcit te rrethit te Podujeves jane tue marre pjese te gjane dhe aktive per realizimin e te gjitha obligimeve te marruna persiper ne ndere te Kongresit. Perveç nji vargu obligimesh ne lidhje me rregullimin dhe perparimin e katundeve te veta, organizatat e Frontit kane marre persiper qe deri ne diten e Kongresit t'a nderlojne shtepin kooperative. Simbas rezultateve te garave te deritashme qe zhvillohen ne mes te katundeve dhe ne mes te çdo antari te Frontit veç e veç, asht konstatue se organizatat e Frontit te ketij keshilli vendi jane dallue ma te mirat ne mbare rrethin e Podujeves. Per kete arsye, frontistave te ketij vendi u asht dhane flamuri kalimtar i keshillit te rrethit te Frontit populluer. Me kete rast frontistat e ketij vendi kan marre persiper obligime te reja. Per punen e deritashme jane lavdue frontistat Rrustem Bilalli, i cili deri tash ka dhane 70 dite pune vullnetare per ndertimin e shtepis kooperative, mandej Hapullah Brahimi, qe ka dhane 65 dite pune dhe Rrustem Alili qe ka dhane 42 dite pune vullnetare.

Kolektivi punes i minjeres „Kosova" asht tue krye me ndere obligimet e marruna persiper

I tane kolektivi punes i minjeres „Kosova" i asht pervesh punes me serjozitetin ma te madh per kryemjen e te gjitha obligimeve te marruna persiper ne ndere te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis. Minatori Mirko Aušiq, tue punue jasht ora i, nxjerre per çdo dite, nga pese vagona mineral. Drejtori i sipermarrjes Jovo Vojoviq, perveç premtimeve te shumta punon per dite edhe ne transportimin e mineralit. Ky ka marre persiper qe deri ne diten e Kongresit te nxjerre njiqind vagona mineral.

I riu, Islam Rexhepi luft.n, gjithashtu, qe deri ne diten e Kongresit t'a plotesoje premtimin e dhanun per me nxjerre 150 vagona mineral.

Grupi i bulumiasve e tejkalon normen per çdo dite me 20 per qind.

Kolektivi punes i kesaj minjere ka marre persiper me dhane deri ne diten e Kongresit 34.700 ore pune vullnetare

REZULTATET E PARA TE REGJISTRIMIT TE HUAS POPULLORE

Tue regjistrue Huan popullore popujt t'one po e vertetojne vendosmenin e vet, qe nen udheheqjen e partis Komuniste te Jugosllavis dhe shokut Tito te ndertojne socjalizmin ne Vendin t'one

Mbare populli i Krahines s'one-ne qytete e katunde, sipermarrje e institute dhe neper te gjitha vendet e punes, e ka prite diten e fillimit te regjistrimit te Huas popullore me enthuzjazem dhe asht paraqite ne menyre solemne per te regjistrue Huan popullore, per te krye ket detyre nderi qe ka me e shpejtesue ndertimin e jetes ma te mire e ma te lumtun per te gjithe njerzit punues.

Tue e prite Kongresin e Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis me gara te gjithanshme, njerzit punonjes te Krahines s'one kane marre persiper me e regjistrue Huan qysh ne diten e pare dhe ne shum vende asht plotesue premtimi i dhanun.

Qysh n'oret e para te mengjezit te dates 1 korrik, puntoret e sipermarrjeve dhe instituteve, antaret e Frontit, burra, gra te reja dhe pioniere kane dale ne vendet e caktueme per t'i regjistrue kursimet e veta, per te plotesue detyren e vet ndaj shtetit t'one populluer, ndaj Partis dhe shokut Tito.

Rezultatet e para na tregojne se njerzit punonjes te Krahines s'one jane te gatshem me ba perpjekje edhe ma te mdhaja per realizimin e te gjitha detyrave qe u parashtrohen me Planin t'one pesvjeçar. Keto rezultate tregojne vendosmenia e njerzve t'one punonjes, qe nen udheheqjen e Partis Komuniste te Jugosllavis, te ndertojne socjalizmin ne Vendin t'one; tregojne dashunin e madhe ndaj shokut Tito dhe besimin e pathyeshem ndaj Komitetit Qendruer te Partis s'one Komuniste.

Ne dy ditet e para jane regjistrue ne mbare Krahinen t'one 39.128,000 dinare

Rrethi i Mitrovices	6.915.000 dinare	Rrethi i Kamenices	1.227.000 dinare
Qyteti i Prishtines	5.043.000 „	Rrethi i Gjurakovcit	1.198.000 „
Qyteti i Mitrovices	3.682.000 „	Rrethi i Rahovecit	1.129.000 „
Rrethi i Ferizajt	3.031.000 „	Rrethi i Podujeves	1.118.000 „
Qyteti i Prizrenit	3.024.000 „	Rrethi i Liplanit	999.000 „
Qyteti i Pejes	1.984.000 „	Rrethi i Dragashit	984.000 „
Rrethi i Pejes	1.671.000 „	Rrethi i Serbices	961.000 „
Rrethi i Prizrenit	1.441.000 „	Rrethi i Gjakoves	955.000 „
Rrethi i Gillanit	1.397.000 „	Rrethi i Suharekes	716.000 „
Rrethi i Prishtines	1.244.000 „	Rrethi i Viçiternes	409.000 „

Asht per t'u vue ne dukje se sejeta e dhanjes se referateve nuk asht tue funksjonue ashtu siç duhet ne mes te komisjoneve te vendeve dhe te rretheve, keshtu qe gadi gjysa keshillave te vendeve te Krahines s'one nuk i ka dhane ende rezultatet definitive. Keshtu p. sh. ka ngja qe ne rrethin e Pejes nji keshill vendi te mos dergoje kurrfare lajmesh gjate dy ditve. Disa komisjone nuk i kane dergue referatet e plota si sh. rrethi i Prishtines ka lajmerue veçem shumat e pagueme te Huas a jo edhe ato te regjistrueme etj.

Deklarata e Komitetit Qendror të Partis Komuniste të Jugosllavis ne lidhje me Rezoluten e Byros Informative te partive Komuniste mbi gjendjen ne Partin Komuniste te Jugosllavis

(vijon nga faqja e parë)

ushtarake sovjetike e se specjalistat civile jane gjurmue nga organet e sigurimit nuk i pergjigjet se vertetes aspak. Deri ne shkuemjen e atyne asnji prej perfaqesuesave te Bashkimit Sovjetik as qe u ka bere ndonji here vrejtjen per kte perfaqesuesave jugosllave. Asht kryekput rreme pohimi se ndokush nga perfaqesuesat sovjetike asht gjurmue ne Jugosllavi, se ma shoku Judin ja se ja. Kjo thanje e sidomos ajo ne lidhje me shokun Judin, ka per qellim vetem e vetem me e diskreditue PKJ dhe udheheqjen e saje para partive tjera.

Perkundrazi, e vertete asht thanja e jone qe asht paraqite ne letren dergue Komitetit Qendruer te PK (b) te BRSS me 13 prill, e qe bazohet ne nji seri deklaratash t'antarve te PKJ, dhanun organizatave te tyne te Partis, si dhe te qytetarve tjere te Vendit t'one, prej çlirimit e deri me sot, se organet e sherbimit informativ sovjetik i kane perdore ne nji menyre te papertillun. KQ i PKJ ka konsiderue se qendrimi i ketille ndaj Vendit, ku komunistat jane parti sunduese e qe dikon ne socjalizem — asht qendrim i palejueshem dhe çon kah demoralizimi i qytetarve te PKJ dhe kah dobsimi dhe minimi i udheheqjes shtetnore e te Partis. KQ i PKJ ka konsiderue dhe konsideron se qendrimi i Jugosllavis ndaj BRSS pa tjeter duhet te bazohet vetem ne bazen e besimit dhe sinqeritetit dhe, tue iu permbajte ketij principi, organeve shtetnore jugosllave us nuk u ka shkue kurrkund ndermend me i gjurmue ase me i kontrollue, ne çfardo menyre qofte, qytetaret e Bashkimit Sovjetik ne Jugosllavi.

E treta, ne rezolute kritikohet politika e PKJ persa i perket zhvillimit te luftes se klases, e sidomos politika e PKJ ne katund. Ne lidhje me kete permenden citatet e njohuna te Lenjinit. KQ i PKJ theksoni se ne politiken e tij te kufizimit t'elementave kapitalista ne katund, bazohet ne citatet e permenduna, e ne te tjerat si kto te Lenjinit, gja qe autoret e rezolutes — sikur t'ishin mundue — do te kishin muejte me e lexue ne dokumentat dhe artikujt e shpallun te Partis dhe me u binde per zbatimin praktik te kesaj politike. Prandaj akuzat e Rezolutes dhe te KQ te PK (b) te BRSS ne realitet jane fare te kota, ndersa objektivisht perbajne doemosdo nji inkurajim e perkrahje ne favor t'elementave reakcjonar e kapitalista te qytetit e katundit, ngjallin peshtjellim ne popullsi. Thone se per veshtirsinat objektive, sidomos persa i perket furnizimit, ne perjudhen e kalimit prej kapitalizmit drejte socjalizmit, asht fajtor KQ i KPJ dhe politika e tij. KQ i PKJ konsideron se, si metode, asht i palejueshem gjykimi mbi veprimtarin e tij ne baze te ndonji citati te shkeputun prej llojlloj perjudhash te luftes ase ne baze te disa fakteve, te marruna veç e veç e bile edhe te shtrembnueme. KQ i PKJ konsideron se ne gjykimin mbi politiken e PKJ si dhe te partive tjera, duhet te merret ne rend te pare praktika e Partis, — ne se Partija mberine apo nuk mberine sukses ne lufte per transformimin socjalist te vendit, ne se ne fund dobesohen apo forcohen elementat kapitalista, ne se dobesohet apo forcohet sektori socjalist i ekonomis popullore.

E katerta: KQ i PKJ nuk ka se si te mos e hudhe poshte me indinjate te thelle pohimin se gjoja faktoret udheheqes te PKJ rreshqasin e bijne ne rrugen e partis kulake, ne rrugen e likuidimit te PKJ, se si ne Parti nuk ka demokraci, se si ne Parti perdoren metodat e udheheqjes ushtarake, se si ne Parti shkilen te drejtat ma themeltare t'antarve te Partis dhe se edhe per kritiken ma te bute te punve jokorrekte ne Parti, jepet pergjigja me represalje t'ashpra etj. A thue kishin muejte antaret e Partis, — qe neper mija luftime e kane kqyre pa frige vdekjen ne sy, — me durue ne Parti gjendjen qe nuk asht e denje per njerez, per komunista? Pohimet se si ne Parti nuk gjendet me u kritikue etj. se keto, duen te thone me fyre tmerresisht çdo antar te Partis s'onë me turpnue te kaluemen heroike e te lavdishme te Partis dhe luften se saj te sotshme heroike per rindertimin dhe ndertimin e Vendit. KQ i PKJ nenvizon se nga fakti qe ne disa organizata te Partis akoma nuk jane kerye votimet, nuk mund te pohohet se ne Parti nuk ka demokraci. Keto jane mbeturina te kohes se luftes dhe te zhvillimit te stabilshem te mbasluftes neper te cilin ka kalue PKJ, e kso sikur ka pase edhe ne partinat tjera, e edhe ne PK (b) te BRSS.

E persa i perket pohimit se Partija po shkaperderdhet ne Front, se faktoret udheheqes po shmangen ne rrugen e partis kulake, si, objektivisht çon drejte shkatrrimit t'aleances te turmave punuese te realizueme nen udheheqjen e klases puntore, ne nji organizate unike — Frontin popullor, drejte izolimit te Partis nga turmat punuese. Burimi i ketij pohimi, perveç sa u-tha, gjindet ne moskuptimin e marredhanjeve ne mes te Partis dhe te Frontit ne Jugosllavi, ne moskuptimin e permbajtjes se Frontit ne Jugosllavi dhe menyres se realizimit te rolit udheheqes te klases puntore ne te. Edhe ne kete çashtje nuk merren per baze faktet, por thanjet e kurdisuna, me ane te cilave, mandej, polemizohet gjoja ne baze te citateve te njohuna te lenjinizmit, te cilat asnji pergjegjes ne PKJ nuk i ka mohue kurre. E, faktet, si dhe deklaratat e shumta gjate gjithe luftes dhe mbas saje — jo vetem te komunistave, por edhe te jo-komunistave ne Front — tregojne: e para: se ne Front, forci udheheqese asht Partija Komuniste; e dyta, se Partija Komuniste nuk shkaperderdhet ne Front, por per kundrazi, Partija i ngrene ideologjikisht e politikisht turmat themelore te frontistave tue i edukue ne frymen e po ... se vet te marksizem-lenjinizmit; e treta, se Fronti popullor i Jugosllavis, ne praktike lufton per socjalizem, çka, natyrisht, nuk do t'ishte e mundun sikur ne te te mujshin ndonji çfardo roli serjoz „grupet politike laramane" — partit borgjeze, kulaket, tregtaret, fabrikantat e vegjel etj., kesisoji sikurse thohet ne Rezolucjon, ase sikur ai t'ish koalicjon ne mes te Partis Komuniste dhe partive tjera ase forme marreveshtjeje ne mes te proletarjatit me borgjezin; e katerta, se Partija nuk e merr programin nga Fronti, por perkundrazi, Fronti e merr drejtimin themeluer dhe programin nga Partija Komuniste, çka asht e natyrshme tue marre parasyshe rolin udheheqes te saje ne te.

KQ i KPJ kein nenvizon se kompaktesimi i matutjeshem ideo-politik i turmave frontiste, nderlidhja e aktivitetit politik te Partis me aktivitetin e Frontit dhe aktiviteti i gjithanshem i Frontit — asht nji nga detyret ma te randesishme te Partis.

Ma ne fund, KQ i PKJ theksoni se shumica e antarve te tij nuk jane te kooptuem, por te zgjedhun. KQ i PK (b) te BRSS ne te llogaritunit e vet, nuk i ka njehe antaret e Byros Politike, qe jane zgjedhe pothuejse ne Konferencen e Peste te PKJ. Prandaj numrit prej 22 antarve te plenumit te KQ te PKJ, qe e permend KQ i PK (b) te BRSS ne nji leter te veten, duhet t'i shtohen edhe 7 antar te byros Politike. Asht gja per çudi me ia zane per te keqe nji Komiteti Qendruer te Partis Komuniste, — i cili ka humbe ne lufte dhete antar te vete qe ne vendet e tyne i ka kooptue shoke, kryesisht nga radhet e kandidatve te KQ te PKJ.

KQ i PKJ e hedhe poshte si qesharak dhe te paverte pohimin mbi ilegalitetin e PKJ dhe konsideron se ai asht perveç tjerash, gjithashtu prove e moskuptimit te formave te punes te PKJ ne kushtet e caktueme e momentet e caktueme. Format e punes te PKJ kane rrjedhe nga kushtet konkrete te praktikes revolucjonare shumvjeçare te Partis s'one; ne kete praktike ato jane tregue si te drejta dhe kane qene faktor i randesishem qe Partija e ka fitue besimin e masave.

E pesta, KQ i PKJ e hedhe poshte si te padenje akuzen se ne Partin Komuniste mbretnon regjimi turk e se udheheqsat jugosllav ia kane mshefe Partis „kritiken e politikes jo te drejte te KQ, ia kane mshefe Partis dhe popullit arsyenat reale te qerimit te besapeve me shoket Hebrang dhe Zhujoviq". KQ i PKJ nuk ka muejte me i shpalle letrat e KQ te PK (b) te BRSS, pa e ba kte vet KQ i PK (b) te BRSS. Porse mbare aktivit te gjane te PKJ i asht e njoftun permbajtja e letrave te KQ te PK (b) te BRSS, e te gjithe antarve te Partis çashtja e Hebrangut dhe e Zhujoviqit.

KQ te PKJ i duhet me deklarue çudin e vet se si perfaqesuesit e partive — antare te byros Informative, kane muejte qe marre ne mprojtje Hebrangun e Zhujoviqin, pa kerkue nga KQ i PKJ kurrfare informatash. KQ i PKJ çuditet sepse mprohen njerezit si p. sh. Zhujoviqi, i cili ne vitin 1937, ka qene perjashtue se bashku me Gorqinin nga KQ i PKJ vendim te Kominterenes, ase Hebrangun, i cili ka pase qendrim tradhtar para policis s'ustashve, gja per te cilen e ka mashtrue Partin; ata te cilet kane funksjonue ne PKJ dhe jane perpjeke me e shkatrrue ate dhe me sabotue, ne menyre rrenimtare rritjimin e ndertimit dhe industrijalizimit te Jugosllavis. Athue kjo nuk don te thote me perkrahe fraksjonizmin, tradhtaret dhe veprimtarin kriminale kundra PKJ? Ne lidhje me ket KQ i PKJ shpalle, si shtese, materjalet e veta mbi Hebrangun dhe Zhujoviqin.

KQ i PKJ e hjedhe poshte, si absurd, pohimin se ne koben e fundit udheheqesat e Jugosllavis me ngutsi te madhe dhe per arsyena demagogjike kane marre masat mbi nacionalizimin e industris se vogel dhe tregtis se vogel. Ne realitet, keto masa kane qene pregatite 6 muej perpara akuzave te permenduna te KQ te PK (b) te BRSS kundra KQ te PKJ dhe jane rezultat i forcimit dhe zhvillimit te sektorit socjalist.

Citati i shkeputun nga fjalimi i shokut Kardelj ka vetem domethanje te pergjithshme, kurse mbar fjalimi i tij, ne realitet, e paraqet linjen e Partis drejt shtymjes graduale t'elementave kapitalista, ne fazen e tashme.

Ne lidhje me te gjitha keto, bahet e kuptueshme sepse organi i Byros Informative, si edhe shtypi i disa partive te tjera nuk e kane botue ne kohen e fundit asnji lajm mbi suksesset e ndertimit ekonomik ne Jugosllavi, siç jane per shembull: masat per dobsimin e mtejshem t'elementave kapitalista, suksesset ne realizimin e Planit, garat masovike, te para-Kongresit te klases puntore dhe te njerzve punues te bashkuem ne Frontin Popullor etj. Por faktet mbetun fakte. Me heshtjen e tyne nuk mund te mbulohet kritika arbitrare dhe kryekput e pathemelte e politikes ekonomike te Qeveris se RFPJ dhe linjes se KQ te PKJ ne problemat ekonomike.

E shtata, KQ i PKJ pohon se asnjeni prej udheheqesave nuk konsideron se, ne luften per ndertimin e socjalizmit e ruejtjen e pamvaresis Jugosllavis nuk i nevojiten ndihmat e vendeve te demokracis popullore dhe te BRSS. Vetem njerzit qe e kane humbe çdo lidhje me realitetin, te mujshin me pohue nji gja te ketille. KQ te PKJ i duhet kta me theksue se dhanja e kesaj ndihme dhe bashkpunimi nuk mvaret vetem prej tij, por edhe nga vendet e demokracis popullore e nga BRSS. KQ i PKJ konsideron se kjo ndihme duhet te lidhet me politiken e jashtme dhe te mbrendshme te Jugosllavis, e kurresi me faktin qe ai nuk ka mujte me pranue akuzat e pathemelta dhe te mbeshtetuna ne te pa-verteta.

Pohimet se gjoja udheqesat jugosllav pregatiten per koncesjone ne favor t'imperjalistave dhe per me ra n'ujdi me ta mbi pamvaresin e Jugosllavis jane plotesisht te trillueme dhe hyjne ne rradhen e shpifjeve ma te randa kundra Jugosllavis se re.

Porse, Komitetit Qendruer te Partis Komuniste te Jugosllavis i duhet me theksue se ne disa vende te demokracis popullore jane ba, nga ana e organeve te Partis dhe shtetit, nji seri gjestesh te pamira, pa kurrfare shkaku, gjeste te cilat fyejne popujt e Jugosllavis, shtetin e tyne dhe perfaqesuesat e shtetit dhe gojne drejte dobesimit te ketij bashkpunimit te naltepermendun, drejte prishjes se marredhanjeve me Jugosllavin. KQ i PKJ nuk e konsideron vehten t'obliguem qe te heshte, ne t'ardhmen, para kesi fare gjestesh.

E teta, KQ i PKJ nuk konsideron qe-nga se ka refuzue te diskutojne mbi gabimet per te cilat nuk asht fajtuer, e ka cenue kund unitetin e Frontit komunist. Uniteti i ketij Fronti nuk mbeshtetet ne njoftjen e gabimeve dhe shpifjeve te trillueme dhe te kurdisuna, por se faktin ne se politika e nji Partije asht ne te vertete internacjonale apo jo. Njikohesisht, nuk mund te kalohet heshtazi fakti qe Byroja Informative i ka shkele principet mbi te cilat asht themelue, e qe parashifshin vullnetaritetin e çdo partije per sa i perket pranimit te konkluzave. E para, Byroja Informative jo vetem se i shtrengon udheheqsat e PKJ me i njohe gabimet qe nuk i kane ba, por i fton antaret e PKJ me çue krye ne Parti, me shkatrrue unitetin e Partis. KQ i PKJ nuk mundet me pranue kurra qe te diskutohet mbi politiken e tij ne baze te trillimeve, qendrimit jo-shoqnuer, pa besim reciprok. Kjo baze nuk asht parimore, dhe ne kete dhe vetem ne ket drejtim KQ i PKJ ka konsiderue se nuk asht i barabarte ne diskutim dhe se nuk mundet me e pranue diskutimin ne ket baze. E mandej, ne lidhje me sa siper, KQ i PKJ e hjedhe poshte energjikisht akuzen se Partija Komuniste e Jugosllavis ka kalue ne pozitat e nacionalizmit. Me tane politiken e saje te mbrendeshme e te jashtme, e sidomos me luften e saje nacional-çlirimtare, dhe zgjidhjen e drejte te çashtjes nacionale ne Jugosllavi, PKJ e ka provue kryekput te kunderten.

Me akuzat e padrejta te naltpermenduna, Partis s'one, klases s'one puntore dhe turmave punuese, popujve te Jugosllavis, pergjithesisht, dhe luftes se tyne te sinqert dhe heroike i asht ba padrejtesija historike ma e madhja. Komitetit Qendruer te PKJ i asht e kjarte se akuzat e KQ te PK (b) te BRSS do t'i qerytezoje propaganda armike per me shpife kundra Bashkimit Sovjetik, Jugosllavis dhe Vendeve te tjera demokratike. Porse, KQ i PKJ deklaron se nuk mban kurrfare pergjegjesije per te gjitha keto çashtje mbasi me kurrfare gjesti te tijin, nuk i ka shkaktue.

KQ i PKJ i fton te gjithe antaret e Partis qe t'i shtrengojne rradhat e veta ne luften per zbatimin e linjes se Partis dhe per forcimin edhe ma te madh t'unitetit te Partis, e klasen puntore dhe turmat e tjera punuese, te bashkueme ne Frontin popullor, t'a vijojne edhe ma me energji punen ne ndertimin e atdheut t'one socjalist. Kjo asht e vetmja rruge dhe menyre qe t'a provojne ne praktike se akuzat e naltpermenduna jane fare te padrejta.

Beograd, 29-VII-1948.

Plenumi i Komitetit Qendruer te Partis Komuniste te Jugosllavis

Deklarata e Komitetit Qendruer te PKJ e 20 qershorit drejtue sesjonit te Byros Informative

Byros Informative

Ne lidhje me ftesen qe ka marre per me i dergue perfaqesuesit e vet ne mbledhjen e Byros Informative, e cila tash-ma asht mbledhe per me diskutue mbi gjendjen ne PKJ, KQ i PKJ lutet qe mbledhjes se Byros Informative t'i komunikohet sa vijon:

KQ i PKJ asht i gatshem gjithmone me marre pjese ne punen e Byros Informative. Por ai nuk mundet me i dergue perfaqesuesit e tij ne ket mbledhje te Byros, mbasi nuk aprovon rendin e dites te mbledhjes, tue konsiderue se zgjidhja e çashtjes se mosmarreveshtjeve midis KQ te Pk (b) te BRSS dhe te KQ te PKJ çka perban mbrendin e rendit te dites qe na asht komunikue, prej fillimit e deri ne ket mbledhje te Byros nuk ka qene shtrue si duhet, per arsyet si vijojne:

E para. - Qysh ne letren e pare te KQ te PK (b) te BRSS drejtue KQ t'onit çashtja nuk ka qene paraqite ne fryme kritike shoqnore, se ciles KQ i PKJ do te kishte mujte me iu pergjegje me te njajtin ton, por ne forme akuze t'ashper e te padrejte, te cilen tue marre parasyshe pavertetsin e saje na kishim mujte me e pranue vetem ne dam te Partis dhe te shtetit t'one ase mos me e pranue:

E dyta. - KQ i PK e konsideron thellesisht te pa drejte bazimin e akuzave kundra nji partije Komuniste moter n'informata te nji aneshme te pshtetuna ne thashe e themet e disave ase ne citate te marruna ne menyre te izolueme, e jo ne baze t'analizes se mbare veprimtaris se Partis s'one, e cila ka kalue neper prova aq te mdha para luftes e gjate e luftes e mbas luftes.

E treta. - Disa prej akuzave ma te randesishme te KQ te PK (b) te BRSS bazohen kjartazi n'informatat e elementave anti-Parti kunder te cilve Partija e jone ka luftue para luftes, gjate luftes e mbas luftes. KQ i PKJ e konsideron si te palejueshme qe mbeturinat e ketilla te njoftun te fraksjonizmit te dikurshem ne PKJ te gezojne perkrahjen e KQ te PK (b) te BRSS:

E katerta. - Udheheqesinat e partive antare te Byros Informative, tue e pranue ne menyre jo kritike akuzen e KQ te PK (b) te BRSS kundra Partis s,one dhe tue mos kerkue prej nesh kurrfare informatash e kane gjykue, Partin t'one nder deklarata me shkrim dhe kane refuzue te marrin parasyshe argumentet e pergjegjes s'one letres se pare te KQ te PK (b) te BRSS. Disa prej tyne ne rrethin e gjane te partive te veter e bile dhe haptazi, kane veprue ne dam t'atdheut t'one.

E pesta. — KQ i PK (b) te BRSS nuk ka pranue asnji nga argumentat e pergjegjes s'one letres se tij te pare, porse ne pergjegjen dhanun kesaj letre e ma vone, ka paraqite akuza gjithnji kryekput te pathemelta kundra PKJ. Asht e kjarte, se nji qendrim i ketille nena ban te pamundshem diskutimin ne baze te barabarsis.

Te gjitha keto fakte jane arsyeja per te cilen KQ i PKJ nuk asht pajtue qe te paraqiten mosmarreveshtjet ne Byron Informative, tue konsiderue se kjo do te sjellte vetem thellimin e jo zgjidhjen e mosmarreveshtjeve.

Le te dihet dhe kjo, se KQ i PKJ i ka propozue KQ te PK. (b) te BRSS t'i dergoje perfaquesit e tij ne Jugosllavi qe te shqyrtojshin se bashku mu ne vend çashtjet ne kontestim;

(Vazhdou ne faqen e trete)

VENDIMI I KOMITETIT QENDRUER TE PARTIS KOMUNISTE TE JUGOSLLAVIS MBI PERJASHTIMIN E ANDRIJA HEBRANGUT E SRETEN ZHUJOVIQIT NGA PARTIJA KOMUNISTE E JUGOSLLAVIS

Te gjithe antarve te Partis Komuniste te Jugosllavis

Ne baze te vendimit te Plenumit te Komitetit Qendruer te Partis Komuniste te Jugosllavis date 13 prill 1948 qe te fotmobet komisjoni i Partis nga shoket: Bilagoje Neshkoviq, Ivan Goshnjak e Vida Tomshiq per me e shqyrtue çashtjen e veprimtaris antiparti te Sreten Zhujoviqit e Andrija Hebrangut, komisjoni e perfundoi punen. Byroja Politike e KQ te PKJ muer nga Komisjoni i permendun raportin dhe propozimet ne lidhje me veprimtarin antiparti te Sreten Zhujoviqit e Andrija Hebrangut.

Byroja Politike e KQ PKJ i aprovon ne tanesi konkluzat dhe propozimet ne lidhje me veprimtarin antiparti te Sreten Zhujoviqit e Andrija Hebrangut dhe vendose perjashtimin nga Partija t'Andrija Hebrangut dhe Sreten Zhujoviqit.

Bashkangjitun u paraqitet anetareve raporti dhe propozimi i komisjonit ne lidhje me veprimtarin antiparti te Sreten Zhujoviqit e Andrija Hebrangut, si dhe vendimi i Byros Politike te KQ te PKJ ne lidhje me çashtjen e Sreten Zhujoviqit e Andrija Hebrangut date 19. IV. 1946.

Byroja politike e KQ te PKJ.

Komitetit Qendruer te partis Komuniste te Jugosllavis

Komisjoni i Partis i perbame prej: Bilagoje Neshkoviq, Ivan Goshnjakut e Vida Tomshiqit, i zgjedhun ne sesjonin plenar te KQ te PKJ me date 13 prill 1948, per me shqyrtue punen e Andrija Hebrangut e te Sreten Zhujoviq e perfundoi punen dhe konstatoi sa vijon:

Andrija Hebrang e Sreten Zhujoviq jane elementa antiparti te nderlidhun ngushte shoq me shoq, te cilet kane punue kundra Partis Komuniste te Jugosllavis dhe Komitetit Qendruer te Partis Komuniste te Jugosllavis. Ata jane perpjeke me e shkatrrue Partin Komuniste te Jugosllavis, por nuk ia kane dale ne saje te kompaktesis dhe unitetit te Partis Komuniste te Jugosllavis dhe syçelis se Komitetit Qendruer te Partis Komuniste te Jugosllavis.

Se te gjitha keto jane te verteta, ket e verteton edhe vendimi i bashkangjitun i Byros Politike te Komitetit Qendruer te Partis Komuniste te Jugosllavis ne lidhje me çashtjen Hebrang-Zhujoviq, date 19 prill 1946.

Tue shqyrtue punen e Andrija Hebrangut, komisjoni i Partis ka konstatue:

1.—a) se Andrija Hebrang kur ka qene ne burg, ka qene i denuem me qortim per shkak te punes se tij frankcjoniste;

b) se Andrija Hebrang ne vjetin 1941 asht denue nga ana e KQ te PKJ me vrejtje (mbassi ai atehere nuk ka tregue se si ma perpara ka qene i denuem me qortim) per shkak te mos-syçeltis kundrejt tentativave te perçamjes s'unitetit te Partis dhe per shkak te mos-permbashtjes se direktivave te KQ te PKJ per organizimin e kryengritjes popullore;

c) se Andrija Hebrang, ne vjetin 1944, asht hjeke nga detyra e sekretarit te KQ te Partis Komuniste te Kroacis per shkak te qendrimit mbi çashtjet e Frontit Popullor, per shkak te politikes se gabueshme kundrejt turmave, qe ishin nen influencen e Partis Komuniste Kroate dhe per shkak te topitjes se luftes kundra ustasheve;

d) se Andrija Hebrang ne vjetin 1948, asht denue me perjashtim nga Byroja Politike e KQ te PKJ dhe me denimin e Partis — qortim i rande: njikohesisht asht hjeke nga funkcjona i kryetarit te Keshillit Ekonomik per shkak se ka tentue qe mospajtimin e tij me politiken ekonomike te Komitetit Qendruer te PKJ dhe qeveris se RFPJ t'a maskonte me intoleroncen e shokut Tito ndaj tij (shif vendimin e bashkangjitun te Byros Politike te KQ te PKJ ne lidhje me çashtjen Zhujoviq—Hebrang, date 19 prill 1946).

2. a) se mbas burgimit t'Andrija Hebrangut u zbulue organizata e Partis ne Kroaci, zbulimi i cili ngjau ne lidhje me trathtin e Andrija Hebrangut, gja qe e verteton deklarata e ma vonshme e Govorushiqit, me te cilin Hebrangu mbante lidhje personale, dhe nga e cila shifet se e ka ngarkue Hebrangu;

b) se Hebrangu, i njoftun prej ustasheve si funkcjoner i nalte i Partis Komuniste u-shkembye, nen rrethana krejtsisht te dyshimta, ne vjetin 1942, gja qe shenon te vetmin rast ne Vendin t'one.

3.- Andrija Hebrang ka peshperite dhe zhvillue lufte fraksjoniste, mbas daljes nga burgu ustash ne vitin 1942, kundra disa antarve te KQ te PKJ, e veçanrisht kundra shokut Tito; e ka pengue zbatimin e linjes se Partis n'ekonomi, tue perhape koshjentisht demoralizimin ne rrethin e vet; ka ndjeke politike shoviniste.

Mbi sa siper, komisjoni ka konstatue ne baze te fakteve te shumta, nga te cilat paraqiten te poshtshenuemet:

a) Andrija Hebrang e ka veshtirsue pruemjen me kohe te planit Pesvjeçar. Kur ne vitin 1945 u-dha direktiva qe te fillohet perpilimi i planit Pesvjeçar neper resoret ekonomike, Andrija Hebrang mpronte mejtimin se duhet ma se pari me e ba planin „e pergjithshem" e kur resoret ekonomike i hartuen planet e veta Pesvjeçare, Andrija Hebrang i mbajti ato plane me nga gjasht muej ne syzat e tryezes se tij. Kah fundi i vjetit 1946, kur KQ i PKJ e dha direktiven qe te fillonte me nji here hartimi i planit te pergjithshem Pesvjeçar, Andrija Hebrang filloi me e mprojte pikpamjen e kundert me mejtimin e tij te ma parshem, d. m. th. se asht e pa mundun me e hartue planin e pergjithshem Pesvjeçar, e se duhet hartue vetem planin njivjeçar.

b) Kundrejt katundaris ne tanesi Andrija Hebrangu propozoi ne menyre cinike aso masash anmike, te cilat s'ishin tjeter perveçse tendenca se kundra katundaris duhet te merren masa represive, posa te haset ne veshtirsina, e nga ana tjeter e karakterizoi linjen e KQ mbi çashtjen e kooperativizmit si oportunizem te kulluem;

c) Andrija Hebrang ka lane mbas vehtes nji kaos ne Keshillin Ekonomik dhe ne Komisjonin e Planit e per punen e komisjoneve republikane te planit nuk u interesue aspak;

d) Andrija Hebrang asht perpjeke me ndjeke politiken ekonomike te kapitalizmit shtetnuer; gjate ane kohes qe ka qene ne poziten e kryetarit te Keshillit Ekonomik e te Komisjonit te Planit, ka sabotue çdo mase serjoze, e cila me te vertete do te shenonte vuemjen e metodes socjaliste te planifikimit n'ekonomin t'one, e nuk ka marre masa perkatese organizative ne pajtim me nevojat e sektorit socijalist, si ma themelori e ma i fuqishmi ne Vendin t'one dhe aq ma teper, i ka kundershtue vendimet e Komitetit Qendruer qe orjentoheshin ne ket drejtim. Kur Andrija Hebrangut, ne gjysmen e dyte te vitit 1947 iu shtrue detyra qe Komisjoni i Planit t'ia hyje perpunimit te metodologjis se planifikimit, ai e çon zhag ket gja deri ne fund te vjetit, e atehere komunikoi se nuk mundet me e hartue sepse i duhej me ia hye hartimit te planit per vitin 1948. Mirepo, kur resoret e ndryshem e hartuen planin per vitin 1948, atehere deklaroi se ato plane ishin ireale dhe se s'ishte e mundun qe te realizohen e ne praktike e ka çue zhag dhe e ka pengue hartimin e planit per vjetin 1948. Per ket arsye plani i vitit 1948 nuk asht prue me kohe dhe prandaj resoret t'one ekonomik s'e kane pase planin e caktuem kjartazi deri ne fund te kuartalit te pare te vjetit 1948. Ne ket menyre Andrija Hebrangu i ka shkaktue dame shum te mdhaja materjale ekonomis s'one e Vendit t'one;

e) Andrija Hebrangu asht perpjeke, ne menyre te ndryeshme, me e ba te pa — mundeshem ndertimin e autostrades „Vllaznimi — Bashkimi" Beograd — Zagreb.

f) Andrija Hebrang asht perpjeke me e ba te pamundshem ndertimin e hekur-udhave Berçko—Banoviqi e Shamac—Sarajeve.

g) Andrija Hebrang asht perpjeke me i demoralizue funksjonaret me pergjegjesi te Partis e te shtetit me deklarata si p. sh. se „do t'a çelim kanalin Danub—Tisa—Danub vetem me lopata", pra se nuk do t'a ndertojme, se nuk mundemi me planifikue asgja ne lidhje me ekonomin individuale katundare e pra, se duhet me i ngrijt duert perpjete e mos me ia hy realizimit te Planit pesvjeçar ne bujqesi; se duhet me e shlye nga plani gjithçkafen ne zbatimin e secilles hasen veshtirsina, çka Andrija Hebrang asht perpjke edhe me e ba, e tj. etj.

h) Andrija Hebrang, me punen e tij shkatrrimtare e ka dhene shovenizmin dhe me te asht perpjeke me e shkatrrue vllaznimin e popujve t'one, fitue me gjak gja qe shifet nga nji seri gjestesh te tija; ai ka thane se mbare Sremi duhet te jete ne kuadrin e Kroacis dhe kesisoji ka mprojte pikpamjen e njoftun ustashe etj.

4.- Andrija Hebrang e ka paraqite rrejshem gjendjen ne Vendin t'one, ka shpife kundra KQ te PKJ dhe disa antarve te KQ te PKJ te miqet t'one te Bashkimit Sovjetik si edhe te te tjeret, me te cilet ka ra ne kontakt. Ne ket menyre ai asht perpjeke me e mshefe punen dhe tendencat e tija antiparti, fraksioniste e anmiqsore me miqesin e tij te rrejshme ndaj Bashkimit Sovjetik.

Dhe ma ne fund komisjoni ka pase ne dore dokumenta te kohes ma t'aferme nga te cilat shifet se Andrija Hebrang ka mbajte nji qendrim trathetar, kur asht burgose nga ushtrija ustashe ne vjetin 1942 ne Zagreb dhe se atehere ka marre persiper se do te punoje per regjimin ustash dhe policin ustashe.

Ne baze te gjithe sa u paraqit ma siper komisjoni konkludon se deri ne lufte, ne kohen e luftes e mbas luftes Andrija Hebrang ka zhvillue nji lufte frankcjoniste ne Partin t'one, se mbas shkembimit ne vjetin 1942 e ka rrejte Partin ne lidhje me qendrimin e tij dhe keshtu mundi me u-fute ne funkcjone me pergjegjsi te partis dhe te shtetit dhe ne vjetin 1943, te kooptohet ne Komitetin Qendruer dhe Byron politike te KQ te PKJ; se ne kohen e luftes ka ndjeke politiken shoviniste dhe politiken e perçamjes se frontit popullor, se mbas çlirimit e ka pengue ndertimin e vendit dhe se e ka sabotue linjen e KQ ne problemet ekonomike.

Komisjoni gjithashtu ka konkludue, si ne baze te dokumentave te permenduna, ashtu edhe ne baze te marrjes ne pyetje t'Andrija Hebrangut para komisjonit, se qendrimi i tij para policis ustashe nuk ka qene vetem trathtar dhe kapitullues, por edhe ngjalle dyshimin e justifikueshem se ka hye ne sherbim te policis ustashe.

II

Per Sreten Zhujoviqin komisjoni ka konstatue:

1.- se Sreten Zhujoviq asht frakcjonist i perbetuem nga tarafi i Gorkiqit dhe se Sreten Zhujoviq ka luftue gjithnji mesheftazi kundra PKJ, kundra KQ te PKJ dhe kundra shokut Tito.

Komisjoni i Partis e ka konstatue kete ne baze te ketyne fakteve:

a) qe Zhujoviqi asht perjashtue nga KQ i PKJ ne vjetin 1937 me rastin e shperndamjes se KQ ku si sekretar ka qene Gorkiqi;

b) qe mbas kesaj nga KQ i ri me shokun Tito ne krye, S. Zhujoviq ka qene denue me qortim, per shkak te nderlidhjes se tij frakcjoniste me spijunin Gorkiq;

c) qe deri edhe ne vitin 1940, e edhe mbas, si u-konstatue ne hetimin e bame nga Partija, ai e ka rrite Gorkiqin para anetarve te Partis;

d) qe ne momentin ma te veshtire t'Ofensives se peste ushtroi influence vendimtare qe njisitet e divizjonit te Pare proletar t'a çajne rrethimin ne krye te vet dhe pamvarsisht nga njisit e tjera te rrethueme, pa i perfille urdhnat, krejt te kjarta dhe disa here te perseritura, te komandantit madhor, gja qe, ne realitet, ka dashte me thane krijim'i nji situate kritike per Shtabin madhor, njisinat tjera dhe spitalet;

e) qe ka peshperite kundra shokut Tito dhe ka shpife kundra tij, si gjate luftes nacional-çlirimtare ashtu edhe mbas çlirimit, si per shembull, ne kursin e Partis ne Lijeqevine, para anetarve te shtabit te divizjonit te Pare proletar, para anetarve te shtabit te brigades se Sanshakut, si dhe ne plenumin e KQ te PKJ me 12—13 prill 1948. Po kesi soji S. Zhujoviq ka peshperite e shpife edhe kundra anetarve te tjere te KQ;

f) qe ka zhvillue lufte frakcjoniste kundra vendimeve te KQ te PKJ dhe te qeveris se RFPJ ne çashtjet ekonomike e n'aprovimin e te cilave ka marre pjese edhe vet (zbatimi i sistemit te çmimeve te lidhuna, ndertimi i shtepive kooperative e tjera kesisoji), d. m. th., deri sa nga nji ane, me fjale ne seancat e KQ asht pajtue me te gjitha vendimet, nga ana tjeter ka zhvillue lufte frakcjoniste kundra ketyne vendimeve jashta KQ. Njikohesisht ka shpife kundra KQ se nuk e ka caktue kjarte linjen e zhvillimit ekonomik;

g) qe masat organizative n'ekonomi, te cilat i kane marre KQ e qeverija e RFPJ ne fillim te vjetit 1947 e me te cilat si asht pajtue me fjale, mbasandaj i ka proklamue si masa trockiste, ndersa ai vet ne Ministrin e financavet e ka kundershtue aplikimin e formave te reja t'organizimit te resorve ekonomike, tue i mbajte format e vjetra te trashigueme nga ish Jugosllavija dhe tue zbatue metoden byrokratike ne punen e vet;

2.- Komisjoni e ka konstatue se Sreten Zhujoviqi e ka pengue zbatimin e vendimeve te KQ te PKJ dhe te qeveris se RFPJ ne lidhje me çashtjet ekonomike, gja e cila ka pase per qellim per t'a ba te pamundun realizimin e Planit pesvjeçar. Komisjoni e ka konstatue kete ne baze te ketyne fakteve:

a) qe Sreten Zhujoviq ka deklarue „jo se nuk e marr parasysh çka me thote KQ, por une jam ai qe pergjigjem per politiken financjare dhe e di vet se shka baj", çka don me thane se ai asht perpjeke me punue ne krye te vet e jo ne baze te vendimit te KQ te PKJ dhe qeveris se RFPJ;

b) qe ne mezin e tij ka mbjelle mosbesim ne forcat t'ona e mundesinat t'ona per plotsimin e planit Pesvjeçar dhe ndertimin e socjalizmit ne Vendin t'one;

c) qe ka nxjerre veshtirsina me rastin e planifikimit t'akumulimit; qe e ka prishe besimin e njerzve ne mundesine e plotsimit t'akumulimit te parapame, qe ne fillim te vjetit e ka urdhnue ndihmesin e tij mos me i dhane shokut Kidriç shenimet e evidences rreth plotsimit t'akumulimit per t'a dizorijentue keshtu qeverin e RFPJ, mbassi plotsimi i akumulimit i ka tejkalue shume shumat e parapame me plan, per te cilat ai, perpara, ka pohue ngultazi se jane ireale;

d) qe e ka pengue kreditimin e kooperativizmit, e realizimin e krediteve te caktueme te kooperativizmit e ka pengue me formalitete byrokratike;

e) qe e ka veshtirsue dhe e ka pengue vendosjen e marreveshtjeve normale tregtare ndermjet vendit t'one dhe vendeve tjera, gja me te cilen e ke veshtirsue kryemjen e ndertimit kapital simbas planit Pesvjeçar;

f) qe, nen pretekstin e pa-pregaditshmenis teknike, me muej e muej asht perpjeke me e pengue ndertimin e auto-strades „Vllaznimi e Bashkimi" Beograd—Zagreb;

g) qe, mbi nji seri te tane çashtjesh ka çfaqe qendrime shoviniste, sidomos mbi çashtjet ekonomike dhe masat ekonomike dhe ka pase qendrim nacjonalist ndaj republikave;

3.- Komisjoni ka konstatue se qendrimet shkatrrimtare te S. Zhujoviqit ne çashtjet ekonomike jane identike me qendrimet e Andrija Hebrangut. Komisjoni e ka konstatue ket ne baze te ketyne fakteve:

a) si Zhujoviqi ashtu edhe Hebrangu, çdonjeni vec e vec, kane marre

(vazhdon ne faqen e katert)

(Vijon nga faqja e trete)

KQ i PK (b) te BRSS nuk e pranoi nji hap te ketille, i cili, simbas mendimit t'one asht i vetmi hap i drejte, por, qysh para se me e marre pergjegjen t'one, i paraqiti mosmarreveshtjet perpara partive tjera Byros Informative, d. m. th. ua dergoi po n'ate kohe si dhe neve, tekstin e letres qe na drejtoje ne, e keshtu udheheqesinat e te gjitha partive, perveç asaje françeze e italjane, na komunikuen me shkrim gjykimin e tyne mbi Partin t'one.

Kurrfare gjesti nuk asht ne frymen e mosmarreveshtjeve dhe parimet te vullndetsis, ku bazohet Byroja Informative.

KQ i PKJ qendron gjithnji ne bindjen e tij se vetem shqyrtimi i perbashket i çashtjeve ne kontestim ne kontaktin direkt ndermjet te KQ te PK (b) te BRSS dhe te KQ te PKJ ma ne Jugosllavi asht e vetmja rruge e drejte per zgjidhjen e mosmareveshtjeve te tashme.

KQ i PKJ shpreh keqardhjen e tij te thelle qe mosmarreveshtjet kane marre nga ana e KQ te PK (b) te BRSS, forma te ketilla dhe prap apelon si ne KQ te PK (b) te BRSS dhe ne Byron Informative qe te pajtohen me mendimin t'one mbi nevojen e kontaktit direkt ne mes te KQ te PK (b) te BRSS dhe te KQ te PKJ per zgjidhjen e mosmarreveshtjeve e qe per ket arsye, t'a hjekin nga rendi i dites diskutimin mbi gjendjen ne Partin t'one, tue e pa se diskutimi i ketille, pa pelqimin t'one, asht i padrejte.

KQ i PKJ i pershendete partinat komuniste motra dhe deklaron se kurrfare mosmareveshtjesh nuk do t'a pergojne PKJ me i qendrue besnike edhe tash e mbas politikes se saje te solidarsis dhe bashkimit ma te ngushtit me PK (b) te BRSS dhe partinat e tjera komuniste.

20 qershor 1948

BYROJA POLITIKE E KQ TE PKJ.

VENDIM I KOMITETIT QENDRUER TE PARTIS KOMUNISTE TE JUGOSLLAVIS MBI PERJASHTIMIN E ANDRIJA HEBRANGUT E SRETEN ZHUJOVIQIT NGA PARTIJA KOMUNISTE E JUGOSLLAVIS

(vijon nga faqja e trete)

te njajtin qendrim mosmiqesuer ndaj te gjitha masave ekonomike te KQ te PKJ dhe te qeveris se RFPJ, e bile edhe para personave te tjere kane deklarue „qe, shifnje nji here planin e tyne" — e ketu fjala „e tyne" don me thane i KQ te PKJ dhe qeveris se RFPJ, dhe „qe", don te thote se plani Pesvjeçar s'asht gja dhe se nuk realizohet;

b) si Zhujoviqi ashtu edhe Hebrangu kane pohue, kah fundi i vjetit 1946, se shumat e akumulimit te planifikueme per vjetin 1947 jane irreale e n'emtet e tyne, nen influencen e vet, udheheqesat pergjegjesa kane pohue se plani i akumulimit nga ekonomija per vjetin 1947 nuk mund te jete ma i madh se 12 miljard dinare. Kurse, praktika ka tregue se kjo shume, e parapame keshtu prej tyne asht trefishue;

c) si Hebrangu ashtu edhe Zhujoviqi e kane pengue me te gjitha menyrat inisjativen ekonomike te republikave dhe te Keshillave popullore me masa byrokrate — centraliste e me pretekstin e nevojes se planifikimit te çdo imtesije dhe uplikimit te kursimit, gja qe ne realitet ka qene vetem maske etj. etj.

Te gjitha keto tregojne se Zhujoviqi e Hebrangu kane qene te ndertidhun ngusht ne punen e tyne shkatrrimtare jo vetem ne „theori" por edhe ne praktike.

4.- se Zhujoviqi si sekretar i Keshillit Ekzekutiv te Keshillit Qendruer te Frontit Popullore te Jugosllavis, prej fillimit e ka veshtiresue sistematikisht aktivitetin e Keshillit Qendruer, vererverte asht perpjeke qe puna e Frontit te pasivizohet e keshtu te vemobilizohet Partija ne luft per forcimin e Frontit dhe t'udheheqjit ne te. Ne lidhje me kete asht karakteristik edhe fakti qe Zhujoviqi ka pengue kryemjen e konkluzave, shume here te perseritura, t'udheheqsis shtetnore qe organizatave Sindikale, me qellim te ngritjes kulturore te klases puntore, t'u jepet ndihma e posaçme prej disa qinda miljona dinarve, e ndame nga fondi i akumulimit.

5.- Simbas qendrimit te S. Zhujoviqit ne plenumin e KQ te PKJ ka mujte me u pa kjartas se Zhujoviqi nga ambicjet personale si dhe nga fryma frakcjoniste e shkatrrimtare, ka shpife kundra antarve te Byros Politike te KQ te PKJ dhe kundra Partis s'one te Bashkimi Sovjetik, ka paraqite shpifje ma te poshtra tue i shtrembnue faktet.

Bash ne Plenum ai e mohoj kete, por ma vone, para komisjonit te Partis, i shterngoem nga faktet, e pohoi.

Ne baze te gjithe sa siper, komisjoni i Partis propozon qe:

1.- Andrija Hebrang te perjashtohet nga Partija si element antiparti, si tradhtar dhe vegel e armikut te klases;

2.- Sreten Zhujoviqi te perjashtohet nga Partija si frakcjonist me damke, si element antiparti, si shpifes dhe si armik i Partis s'one dhe Vendit t'one;

3.- Mbassi A. Hebrang dhe S. Zhujoviq i kane dambue interesat e shtetit populluer dhe popullit punues, konsiderojme se organet kompetente te pushtetit populluer duhet t'a shqyrtojne ket pune te tyne.

Beograd me 8 maj 1948.

ANATARET E KOMISJONIT:
Bjlagoje Neshkoviq
Ivan Goshnjak
Vida Tomshiq

Vendimi i Byros Politike te KQ te PKJ ne lidhje me çashtjen e Andrija Hebrangut dhe Sreten Zhujoviqit me 19 prill 1948

Byroja Politike e KQ te PKJ ka marre prej Komisjonit te Partis, te formuem ne lidhje me çashtjen e A. Hebrangut dhe S. Zhujoviqit raportin dhe propozimet dhe i pranoi ne tanesi si ma poshte:

»Ne lidhje me vendimin e KQ te PKJ, date 19 prill 1946, qe te formohet komisjoni prej shokve Rankoviq, Neshkoviq e Goshnjak me detyre qe t'ia paraqese KQ propozimin mbi zgjidhjen e çashtjes ne lidhje me letren e shokut Hebrang, komisjoni ka mberri ne kto konkluza:

1.— Letra e shokut Hebrang, si per kah menyra me te cilen asht shkrue, ashtu edhe per kah menyra me te cilen paraqiten çeshtjet ne te, asht nji çashtje qe nuk e ka çiften ne Byron e KQ te PKJ ç'prej formimit te tij me 1937. Ne leter, shoku Hebrang, ne menyre jo te shendoshe dhe te palejueshme ne Parti, ka shprehe dyshimin ne shokun Tito se gjoja e urren personalisht, per arsye se edhe atij (Hebrangut) i asht drejtue telegrami nga Moska, e prandaj mos-besimi qe ka shoku Tito ne politiken ekonomike te shokut Hebrang ne realitet buron prej kendej. Qendrimi i shokut Hebrang ne mbledhjen e KQ me date 19 prill te ketij vjeti, ka qene jo autokritik dhe provon se ne letren e tij nuk asht çashtja e ndonji zihjeje me shokun Tito, porse te perpjekja qe ndryshimet politike ndermjet shokut Tito, si eksponent i politikes se KQ dhe shokut Hebrang te hidheshin ne terren personal dhe qe ne KQ te futeshin maredhanje jo korrekte dhe menyra te palejueshme te pune. Kete e vertetojne ma se miri deklaratat e pa-verteta dhe te hueja per KQ te shokut Hebrang ne mbledhjen e KQ, date 19 prill te ketij vjeti, se gjoja ne KQ s'ka liri paraqitjeje te mendimeve dhe kritike e autokritike.

2.— Qendrimi i shokut Zhujoviq ne mbledhjen e KQ, date 19 prill te ketij vjeti, ne lidhje me letren e shokut Hebrang, jo vetem shprehe pajtimin, por ne realitet edhe perkrahjen ne favor te qendrimit jo te shendoshe te shokut Hebrang ndaj KQ dhe shokut Tito, si persa u perket maredhanjeve te mbrendshme ne KQ ashtu edhe per sa i perket politikes se gabueshme ekonomike e financjare.

Ne lidhje me sa u-parashtrue siper, komisjoni i propozon KQ te PKJ qe shoku Hebrang te hiqet nga puna e Byros se KQ te PKJ, pervec tjerash, edhe per te sigurue zbatimin e drejte te politikes se Partis n'ekonomi e mandej te denohet me denimin e Partis: qortim i ashper. Komisjoni propozon qe shoku Hebrang t'a leshoje poziten e Ministrit t'Industris ne qeverin Qendrore dhe poziten e Kryetarit te Keshillit Ekonomik. Komisjoni konsideron se shoku Hebrang mund t'a mbaje poziten e Kryetarit te Komisjonit te Planit».

Me 19 prill 1948

BYROJA POLITIKE E KQ TE PKJ

Te çmuemit e frytit te drithnave te bardhe asht baza kryesore per zbatimin e Dekretit mbi mbledhjen e drithnave

Simbas konstatimit te deritashem rezulton se prodhimi i sivjeme asht shum i mire. Sidomos prodhimi i elbit asht ma i mire se i grunit, mbassi ky i fundit asht pak ma i dobet ne disa vende per shkak te barit te keq. Simbas te çmuemit te deritashem prodhimi mesatar i sivjeme asht per 30 per qind ma i mire se ne vjetin e kaluem, e ne disa vende te Metohis edhe per 50 per qind. Ne terenin Gjurakovc — Rakosh, Shushnice — Osojan gruni asht shum i mire.

Me gjithse parashifet qe te lashtat kane me dhane fryt te mire, prej disa komisjoneve te rretheve te çmuemit e prodhimit mesatar nuk asht ba si duhet. Keshtu p.sh. ne rrethin e Gjakoves prodhimi i tershanes asht caktue 2,5 centi per nji hektar, ne rrethin e Dragashit 6 centi per elb, n'ate t'Istokut 7 centi per theken e ne Ferizaj—9 centi per nji hektar. Derisa komisjonet tjera te Krahines luftojne per me e çmue drejte dhe me e gjete gjendjen e vertete te prodhimit, komisjoni i rrethit te Rahovecit don me e zbrite te çmuemit e maparshem te prodhimit mesatar te theknes prej 10 ne 8,8 centi per nji hektar, tue e konsiderue ket te fundit si ma „reale". Kjo rrjedhe nga moskuptimi i randesis se te çmuemit te drejte te prodhimit mesatar te drithnave, nga pa — aftesija profesjonale e antarve te komisjoneve e nga friga e kote se mos po gabojne. Perveç kesaj edhe perbamja e antarve te komisjonit nuk asht si duhet, ai nuk asht aktiv etj.

Te çmuemit ma real i drithnave deritash asht ba nga ana e komisjoneve perkatese ne rrethin e Liqlanit, Prishtines dhe Mitrovices.

Te çmimet e prodhimit mesatar asht detyre me shum randesi qe shtrohet para organeve te pushtetit populluer dhe para komisjoneve te caktueme per ket qellim, sepse te çmuemit sa ma real dhe te shpejte te prodhimit asht baze per t'ua spjegue prodhuesvet dobin dhe randesin e kontraktimit dhe njikohesisht per zbatimin e duhun te Dekretit mbi blemjen e drithnave. N'anen tjeter, nga te çmuemit drejte dhe real mund te konstatohet perqindja e frytit te realizuem simbas planit e per kulturat kryesore dhe mund te bahet bilanci i perpiket i prodhimit bujqesuer ne fund te vjetit.

Komisjonet e vendit dhe te rrethit duhet t'a lane metoden e vjeter te çmimit "me hamendje", por t'a bajne simbas metres katrore. Per çdo katund duhet me e ba caktimine prodhimit simbas terenit e simbas kategorive I, II, III, etj., qofte tue e mate te tane frytin kokerr, te nxjerrun nga nji meter katrore, ase tue i numrue e klasifikue kallij simbas numrit te kokrave. Menyra e caktimit "me hamendje", nuk asht e sigurte dhe shpesh here mundet me e mashtrue ekspertin dhe praktikun ma te mire.

Asht e domosdoshme qe komisjoneve te vendeve t'u epet ndihma e vazhdueshme nga ana e antarve te komisjoneve te rretheve dhe ne to te marrin pjese antaret ma te mire te Frontit - ata qe jane ma te vetedijshem se sa randesi ka krijimi i fondit te drithit per jeten e popullsis punuese qe me klasen t'one puntore ne krye, punon ne ndertimin e atdheut t'one socjalist.

Me 7 Korrik - ne diten e kryengritjes se popullit Serb - do te leshohet ne qarkullim hekurudha e re Prishtine-Kurshumli

Puna per ndertimin e hekurudhes Prishtine - Kurshumli ka pase fillue qyshe ne vjetin 1937, mirepo, nuk asht kene ba gja. Gjate okupacionit jane rrenue disa tunele qe kane qene çele ma pare. Puna per ndertimin e kesaj hekurudhe asht fillue ne vjetin 1945, por me nderpremje per mungese materjali dhe nga puna e parregullt e disa seksioneve te hekurudhes, punimet serjoze kane fillue ne muejin nanduer 1947. Deri tash jane krye te gjitha punimet dhe e tane vija asht shtrue me shina e binare. Tash jane tue u-krye punimet perfundimtare te kesaj hekurudhe te randesishme. Stacjonet hekurudhore jane ngrite dhe rregullimi i mbrendeshem asht ne perfundim e siper. Puna per shtruemjen e vijes hekurudhore me zalle e gure asht tue u-ba me nji ritem te shpejte dhe do te marre fund me 7 te ketij muej - diten e kryengritjes se popullit serb kundra okupatorit dhe trathtarve te mbrendshem. Ne kete dite do te leshohen ne qarkullim, ne menyre solemne, edhe 68 kilometra hekurudhe te re.

Per ndertimin e kesaj hekurudhe jane shque me punen e tyne vetmohuese drejtori i sipermarrjes hekurudhore Nr. 3 Ratko Boshkoviqi, i cili e ka organizue punen mire dhe u ka perballue veshtirsive te ndryshme.

Ne shtruemjen e shinave e binareve jane shque grupet puntore qe drejtohen prej shokve Fetah e Qerim, te cilet, tue zhvillue gara ne ndere te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis, kane shtrue mbrenda dites nga dy kilometra hekurudhe, e me daten 29 qershuer kane shtrue 26000 metra. Brigada tri here sulmuese e rinis se rrethit te Kosaonices, tue u-kthye nga hekurudha Kuçevo-Brodice ka punue vullnetarisht dhete dite per ndertimin e hekurudhes Prishtine—Kurshumli.

Kjo hekurudhe ka randesi te madhe, sepse me ndertimin e saje fillon çfrytzimi i drunit nga pyjet e Kosaonices; do te zhvillohet edhe ma teper ekonomija e rrethit te Kosaonices, Podujeves dhe Prishtines; do te paksohen shpenzimet per transportimin e mallit dhe t'udhtarve ne mes te Krahines s'one dhe Republikes s'one popullore te Serbis. Kjo hekurudhe ka randesi te madhe, mbassi asht edhe nji vije ma e shkurte qe e lidhe Kosmetin me Republiken t'one Popullore te Serbis.

Lajme nga Vendet ballkanike

Deklarata e qeveris bullgare ne lidhje me marredhanjet bullgaro-jugosllave

Sofje-Agjensija telegrafike bullgare lajmeron:

Vendimi i marrun dhe i shpallun mbas konsultes se tete partinave komuniste, n'asnji send nuk i ndryshon marredhanjet miqesore qe egzistojne ndermjet Republikes popullore te Bullgaris dhe Republikes federative popullore te Jugosllavis.

Tue u-mbeshtete ne reciprocitetin e plote, qeverija e Bullgaris do te vazhdoje me bashkpunue me ndere dhe singerisht me qeverin Jugosllave, konform me Paktin e miqesis, bashkpunimit dhe ndihmes reciproke qe i lidhe dy vendet motra dhe i pergjigjet vullnetit te pathyeshem dhe interesave jetesore te popujve te te dy vendeve.

Ne t'ardhme, si dhe deri tash, qeverija bullgare do te kujdohet nga çdo intervence ne punet e mbrendeshme te Jugosllavis, tue e konsiderue ket si detyre themelore reciproke ndermjet dy vendeve mike.

Ne Shqipni ofendohet Jugosllavija

Tirane

Keto dite ne Shqipni kane ndodhe nji seri incidentesh t' organizueme, te cilat i prekin popujt e Jugosllavis, shtetin e Jugosllavis dhe udheheqesat e saje, e kane per qellim prishjen e marredhanjeve jugosllavo-shqiptare.

Ministrija e punve te mbrendshme te Shqipnis, me 30 qershuer ka urdhnue te mbyllet „Libri Jugosllav" dhe te ndalohet shitja e „Borbes". Para lokalere te „Librit Jugosllav" asht vendose roja.

Ministrija shqiptare e arsimit ka dhane urdhnin qe nga librat shkollore te hiqen te gjitha tekstet ku flitet mbi mareshalin Tito, te ndalohen te gjitha kanget mbi mareshalin Tito dhe ne provime mzanesve te mos u bahen pyetje mbi mareshalin Tito.

Neper te gjitha zyrat e entet ka fillue hjekja e fotografinave te mareshalit Tito. Ne lokalet e shoqnis per ndertimin e hekurudhave ndihmes-drejtori Selim Alemeku hyni ne zyren e drejtorit te shoqnis jugosllave Hujbner, u versul fotografis se shokut Tito dhe, tue mbajte me urdhnin mbi hjekjen e fotografis, ka britte: „Qe urdhni i kryetarit te qeveris me i hjeke te gjitha fotografinat e mareshalit Tito". Dy teknicjera jugosllave e kane ndalue energjikisht tue mos lejue qe ne ket menyre te turpshme t' ofendohet udheheqsi i popujve te Jugosllavis.

Perfaqesuesat diplomatike te Jugosllavis kane dhane protesten prane qeveris shqiptare kundra ketyne gjestve antiqesore e brutale si t'organizueme sistematike shqiptare, ashtu edhe te disa individve.

Seksjonet e furnizimit nuk jane tue u-kujdesue sa duhet per furnizimin e sulmuesave

Disa qinda sulmues te Krahines s'one jane barrue pa u- paise me leter njoftimet perkatese per sulmues. Keta jane tue e marre shtesen e furnizimit me mish, sheqer, yndyre, etj. por nuk jane tue u-furnizue me tekstil e me materjal veshmbathjeje.

Nenshtetas te R. P. te Shqipnis me sherbim ne Kosmet - per Huan popullore te Vendit t'one

Ne Krahinen t'one edhe nenshtetasit e Republikes popullore te Shqipnis jane tue marre pjese ne regjistrimin e huas popullore. Deri tash vetem ne Prishtine disa nga nenshtetasit shqiptare kane regjistrue 34.250 dinare. Prej kityne kane regjistrue ne huan popullore:

Mehmet Gjevori 8.000 din., Jani Gjini 5.000 din., Stathi Kostari 5.000 din., Ollga Kostari 3.000 din., Nexhip Habibaj 2.000 din., Riza Dani 2.000 din., Fadil Hota 2.000 din., Salih Kolgeci 2.000 din., Kol Nikaj 2.000 din., Anton Gurashi 2.000 din., Lec Mazreku 1.250 din.

Botim i Keshillit Krahinuer te Frontit populluer—Shtypshkroja Krahinore e Frontit Populluer Pajtimet ne fle ture i pranon: Administrata dhe ekspedicioni.